




## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

### RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR PËR FUSHATËN ZGJEDHORE QERSHOR 2019 TË SUBJEKTIT ELEKTORAL PARTIA "ALEANCA DEMOKRATIKE" (Hartuar sipas formatit të standartizuar nga KQZ-ja)

1



Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,  
Njësia administrative 5 - Tiranë  
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;  
e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail: [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





**RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA "ALEANCA DEMOKRATIKE"**

I. Informacion i Përgjithshëm

A. Informacion ligjor

1) Kuadri ligjor

Përbushja e detyrës sime për kryerjen e auditimit ligjor detyrueshëm të të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019 për subjektin zgjedhor, Partia "Aleanca Demokratike", u krye sipas vendimit të KQZ-së, nr. 740, të datës 31.05.2019, dalë në zbatim të ligjit nr.90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar, datë 22.05.2017.

Realizimi i këtij misioni ka këtë bazë ligjore si më poshtë renditur:

i. Kuadri ligjor

- Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar" i ndryshuar;
- Standartet ndërkombetare të auditimit;
- Ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.90/2017 datë 22.05.2017;
- Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,
- Vendimin nr.740, datë 31.05.2019 "Për shpalljen e rezulttit të shortit për emerimin e eksperteve financiare dhe audituesve ligjore të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.
- Vendimin e KQZ-së nr.152, datë 11.04.2019, "Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore".

ii. Standardet e kontabilitetit të zbatueshme:

- Standartet kombëtare të kontabilitetit (SKK-të)

**B. Objekti i auditimit**

i. Kontrata e shërbimit

Kryerja e misionit të auditimit të fushatës zgjedhore të partisë "Aleanca Demokratike", u realizua sipas kontratës së shërbimit me numër protokollit të KQZ-së 5047, datë 01.06.2019, të lidhur midis KQZ-së, përfaqësuar nga sekretari i

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





përgjithshëm i KQZ-së, z. Ylli MERKAJ dhe audituese ligjore, znj. Fatmira KASTRATI, anëtare e IEKA-s, zotëruese e licencës së IEKA-s, me nr. 14, datë 11.01.2000, me NIPT K46523036S.

Objekti i kësaj kontrate është i përcaktuar në nenin 1, pika 2 të saj dhe ka të bëjë me kryerjen e auditimit të fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjekti zgjedhor, "Partia Aleanca Demokratike", për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019 për partitë politike në përputhje me Kodin Zgjedhor, ligjin nr 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar" i ndryshuar dhe ligjit :Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

3

## ii. Vendimi i KQZ-së

Vendimi i KQZ-së, nr. 740, i datës 31.05.2019, "Për shpalljen e rezulttit të shortit për emërimin e ekspertëve financiar dhe audituesve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019", solli lidhjen e kontratës së shërbimit me numër protokollit të KQZ-së 5047, datë 01.06.2019, përshkruar më sipër në pikën i.

## iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

### Përgjegjësitë e subjektit zgjedhor

Subjekti zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të të dhenave sipas formatit të standardizuar të raportimit financiar për fushatën zgjedhore, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të subjektit zgjedhor.

### Përgjegjësitë e audituesit

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo të gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontroleve të brendshme;

- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm;
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera;
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave të raportimit financiar për fushatën zgjedhore dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

### C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

#### i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Partia "Aleanca Demokratike" është krijuar me urdhërin nr. 13/1, datë 03.11.1992 të Ministrisë së Drejtësisë. Aktet e themelimit dhe të ndryshimeve të drejtimit të kësaj Partie janë të depozituara në regjistrin e partive politike, Drejtimi i sotëm i Partisë bëhet nga z. Eduart Abazi sipas vendimit nr. 6076, datë 22.05.2014, me nr. akti 8807 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Adresa zyrtare e selisë së Partisë është rruga "Murat Toptani", nr 10, Tiranë.

#### ii. Forma e organizimit dhe e menaxhimit (qendra dhe degët rajonale)

Në lidhje me këtë pikë, nuk na u ofrua asnjë informacion nga partia "Aleanca Demokratike", pavarësisht se kjo kërkesë u ripërsërit nga ana e jonë.

### D. PARAQITJA E RAPORTIT TË AUDITIMIT DHE STRUKTURA E TIJ

#### i. Struktura e raportimit të auditimit

- kërkesat formale
- të ardhurat
- shpenzimet

Gjatë realizimit të misionit të auditimit, Audituesja Ligjore ka komunikuar me email, me telefon dhe me takime me z. Eduart Abazi, kryetari i partisë "Aleanca Demokratike", i cili vuri në dispozicion dokumentet financiare të arkës dhe bankës për periudhën 01.01.2019 deri me 30.09.2019.

Partia "Aleanca Demokratike" ka përgatitur raportin e financimit të fushatës zgjedhore dhe e ka deklaruar në KQZ me nr. prot. të KQZ-së 14543, datë 10.10.2019.

Auditimi është kryer në zyrën e Auditueses Ligjore përfshirë këtu edhe komunikimin nëpërmjet postës elektronike dhe telefonit.

---

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail: [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

### I. KËRKESAT FORMALE

#### A. PËRMBLEDHJE

1/ Data e dorëzimit			
	a) dorëzim në formë elektronike		
	b) dorëzim fizik	Po	10.10.2019
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	26.09.2019
3/ Llogaria bankare e veçantë / Personi përgjegjës i financës			
	a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare	Jo	Nuk ka llogari të hapur për fushatën zgjedhore qershor 2019
	b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës	Jo	Nuk ka dokument për lëvizjen e llogarisë bankare të veçantë për fushatën zgjedhore me përjashtim të llogarisë për aktivitetin e vjetor të partisë.
	c) identiteti i personit përgjegjës të financës	Jo	Personi i shpallur në KQZ si përgjegjës për financën është znj. Xheni Baushi por veprimet kryhen nga z.Eduart Abazi, Kryetari partisë AD

5

#### B. ANALIZA

##### a/ Llogaria bankare e veçantë

###### ○ Llogaria bankare

- Partia, "Aleanca Demokratike", nuk ka hapur një llogari bankare të veçantë për fushatën zgjedhore dhe nuk ka marrë marrë donacione që e kalojnë shumën prej 100,000 lekë.
- Informacioni i shpallur në faqen zyrtare të KQZ-së <http://cec.org.al/ep-content/uploads/2019/06/Llogarite-e-posacme-te-partive-politike-per-fushate-zgjedhore-2019-17062019140636.pdf> për numrin e llogarive për fushatën zgjedhore të vitit 2019, nuk është llogari e veçantë për këtë fushatë por është llogaria e subjektit elektoral për aktivitetin e saj normal të përditshëm pranë Union Bank, dega Tiranë, tek Blloku, me IBAN: AL 43214111680196449985020118-lekë
- Kjo pohohet edhe nga vetë kryetari i saj, z.Eduart Abazi në emailin e tij të dt.26.06.2019<sup>1,2</sup>

<sup>1</sup> RAPORTI JAVOR I NDËRMJETEM NR 4 I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA "ALEANCA DEMOKRATIKE", fq.2

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





- Nuk ka deklarime bankare të tjera që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.
- Nga shqyrtimi i raportit të financimit të fushatës zgjedhore rezulton që nuk ka deficit dhe nuk është i balancuar.
- o **Plotësia e informacionit**
  - Nuk është hapur llogari e veçantë për këtë fushatë por është llogaria e subjektit elektoral për aktivitetin e saj normal të përditshëm pranë Union Bank, dega Tiranë, tek Blloku, me IBAN: AL 43214111680196449985020118 në lekë (ALL).
  - Është marrë paraqitja e llogarisë bankare të UB, dega Tiranë, tek Blloku me IBAN: AL 43214111680196449985020118-lekë, e nxjerrë me datë 17 dhjetor 2019 për periudhën 01.01.2019 deri më 17.12.2019 si dhe lëvizjet bankare të kësaj llogarie nga 01.07.2017-31.12.2018.
  - Janë paraqitur nga Partia,(z. Eduart Abazi),dokumentet e arkës për periudhën 01.01.2019-30.09.2019.

**b/ Personi përgjegjës për Financën**

- o **Identiteti i personit përgjegjës për financën:**
  - Nuk ka një person të veçantë që të merret vetëm me financat.
  - Personi përgjegjës i financave sipas regjistrimit të partive politike që na është vënë në dispozicion nga KQZ-ja, nepërmjet emailit, të datës 03 qershor 2019 si dhe sipas raportit financiar të partisë “Aleanca Demokratike”, dorëzuar në KQZ me nr.prot të saj 14543,datë 10.10.2019, është zj. Xheni Baushi.
  - Në kontaktet në zyrën e Partisë (selia e saj), në Tiranë, është komunikuar emri i z. Fatos Bajro<sup>3</sup>, por ky person nuk ishte i angazhuar gjatë këtij viti me financat e partisë AD.
  - Dokumentat financiare më janë vënë në dispozicion nga z. Eduart Abazi,, e cila ka kryer veprime financiare si terheqje në bankë, pagesa me arkë që kanë lidhje me aktivitetin vjetor të partisë, për administrimin e zyrës ku ndodhet selia e Partisë.
  - Z. Eduart Abazi ka të drejtë të nënshkruajë në emër të partisë AD çeqe, transferta, urdhër pagesa.
- o **Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:**
  - Raporti financiar i fushatës zgjedhore qershor 2019, dorëzuar në KQZ me nr.prot të saj 14543,datë 10.10.2019 është hartuar nga z. Eduart Abazi, kryetari i partisë “Aleanca Demokratike”. <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/10/Partia-Aleanca-Demokratike-e-Shqiperise-14102019155721.pdf>

a) bosh/mungon informacioni	Jo	Nuk mungon informacioni	
b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
	Të Ardhurat		
		Financime publike	588,875

<sup>2</sup> RAPORTI I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA “ALEANCA DEMOKRATIKE”, fq 12

<sup>3</sup> RAPORTI I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA “ALEANCA DEMOKRATIKE”, fq 12

Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





# AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

		Donacione private	0
		Financim nga burimet e veta të partisë	0
		Huatë/Kreditë	0
	Shpenzimet		
		Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	0
		Materialet promovuese	67,200
		Media	0
		Sondazhe të Opinionit Publik	0
		Botime	0
		Transporti	0
		Konsulenca	0
		Reklamime në ambiente të hapura	0
		Administrative dhe të përgjithshme	0

7

## II. TË ARDHURAT

### A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi public			
	Shuma e pagesës paradhënie	0	0
	Data e tranfertës		
	Shuma e pagesës së marrë pas zgjedhjeve	588,875	588,875
	Data e transfertës	09.09.2019	09.09.2019
	Shuma e financimit publik e kthyer, nëse ka		
	Data e transfertës		
2/ Donacionet private			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
	Shuma e donacioneve në para	0	0
	Shuma e donacioneve në natyrë	0	0
	Përgatitet një listë e donatorëve		ska

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)



**AUDITUESE LIGJORE**

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)		ska
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (shuma)		N/A (nuk ka)
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		N/A (nuk ka)
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori)		N/A (nuk ka)
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		N/A (nuk ka)
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		N/A (nuk ka)
	Respektimi i kufirit të donacionit		N/A (nuk ka)
<b>3/ Financimi nga burimet e vetë partisë</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	-	-
	Kuotat e anëtarësisë	-	-
	Botimet	-	-
	Shtypshkronja	-	-
	Marrje me qera	-	-
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)	-	-
	Kuotat e anëtarësisë	-	-
	Botimet	-	-
	Shtypshkronja	-	-
	Marrje me qera	-	-
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma)	-	-
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)	-	-
<b>4/ Huatë/Kreditë</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	0	0
	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi /	-	-

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

	hua)		
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)	-	-
5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave			
Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.		588,875	588,875

9

### B. ANALIZA

#### a/ Financimi publik

- Raporti financiar i deklaruar nga Partia “Aleanca Demokratike” përmban të ardhurat e përfituara nga fondet publike me vlerë 588,875 lekë.
- Kjo vlerë është diferenca midis shumës së parashikuar prej 1,156,095 lekë sipas vendimit nr. 830 të KQZ-së, datë 10 qershor 2019 <http://cec.org.al/ep-content/uploads/2019/06/venimi-830.pdf> dhe vlerës që duhej të kthente për 567,220 lekë në respektim të përqindjes së fituar në zgjedhjet vendore qershor 2019 referuar vendimit të KQZ-së nr.10098, datë 27.07.2019 <http://cec.org.al/ep-content/uploads/2019/10/Vendim-10098-Per-shperndarjen-e-fondeve-te-fushates-2019.pdf>
- Shuma e të ardhurave të parashikuara nga fondi publik si paradhënie kanë vlerën 1,156,095 lekë, sipas vendimit të KQZ-së nr.830 dt.10.06.2019 por që nuk janë arkëtuar në llogarinë bankare të kësaj partie me dt.03.07.2019.
- Meqë nuk ka tërheq vlerën e parashikuar, partia “Aleanca Demokratike” nuk ka kthyer as diferencën me vlerë 567,220 lekë në bazë të vendimit të KQZ-së nr.10098, dt.27.07.2019 “Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që përfitojnë partitë politike për zgjedhje e datës 30 qershor 2019”.
- E ardhura e deklaruar nga fondet publike me vlerë 588,875 lekë, që rezultojnë si vlerë neto, sa më sipër sqaruar, është deklaruar si e ardhur në përputhje me përcaktimin ligjor për këto fonde, por mospërputhja që duhet theksuar është data e arkëtitimit të tyre me 09.09.2019 pra 70 (shtatëdhjetë) ditë përtej afatit kohor të përcaktuar në ligj, që është data e ditës së zgjedhjeve.
- Duke marrë në konsideratë, se çështja e datës së arkëtitimit të fondit publik nuk varet nga partia politike por varet nga institucionet publike, nuk e çmojmë problem themelor por çështje për t'u theksuar.
- Gjithashtu dhe mosdeklarimi i fondeve që kanë qenë gjendje në datën e shpalljes së zgjedhjeve pavarësisht se janë kërkesë e ligjit për partitë politike, nuk janë përfshirë në raportin financiar për shkak se nuk janë përdorur për fushatën zgjedhore.

#### b/ Financimi nga burimet jo publike:

- Donatorët e lejuar:
  - Financime jo publike nuk ka pasur në fushatën zgjedhore të 30 qershorit 2019.
- Burimet e palejuara:
  - nuk ka;
- Kontributet në natyrë:
  - nuk ka;
- Kufizimet:
  - Nuk ka shpenzime për fushatën zgjedhore, pra nuk ka shkelje të kufizimeve.

Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





**c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike**

- Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë:
  - o Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas shumave të marra - nuk ka;
  - o Botimet – nuk ka;
  - o Shtypshkronjat – nuk ka;
  - o Marrja me qira, etj – nuk ka;
- Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës:
  - o Zyrat qendrore - 0
  - o Degët lokale – 0
- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruara dhe deklarimit bankar (bank statement)**
  - Po, përputhet natyra dhe vlera e deklaruar e të ardhurave me ato të deklarimit bankar.

d/ Huatë/Kreditë – nuk ka.

**III. SHPENZIME**

**A. PËRMBLEDHJE**

Shuma e përgjithshme e raportuar	447,410 lekë						
Respektimi i kufirit të shpenzimit	Është respektuar kufiri i shpenzimeve						
Shpenzimet e kryera nga zyra qendrore e Partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Aktivitetet të fushatës	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Materialet promovuese	67,200	Po	Nuk ka	Nuk ka	67,200	Nuk ka	67,200
Media	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Sondazhet e opinionit publik	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Botimet	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Transporti	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Konsulenca	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Reklamat në ambientet jashtme	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Administrative dhe të përgjithshme	-	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	-
Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzimet të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet fushatës	-						-
Materialet promovuese	-						-
Media	-						-
Sondazhet e opinionit publik	-						-
Botimet	-						-
Transporti	-						-
Konsulenca	-						-
Reklamat në ambientet jashtme	-						-
Administrative dhe të përgjithshme	-						-
Shpenzimet zgjedhore							
Shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë							Jo

11

### B. ANALIZA

#### a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve:

- Nuk ka tejkalim të kufirit të shpenzimeve. Është respektuar kufiri i përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, sipas nenit 87/3 i cili parashikon që shpenzimet e përgjithshme të bëra nga një parti politike, duke

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail: [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





përfshirë kandidatët e saj, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10 herë shumën më të lartë që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike.

**b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruara dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.**

- Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës : nuk ka;
- Materialet promovuese: selia qendrore e Partisë 67,200 lekë
- Media: nuk ka;
- Sondazhet e opinionit publik: nuk ka;
- Botimet: nuk ka;
- Transporti: nuk ka;
- Konsulenca: nuk ka;
- Reklammat në ambientet e jashtme: nuk ka;
- Administrative dhe të përgjithshme: selia qendrore e Partisë 4,384 lekë.

#### **IV. PËRFUNDIMI**

##### **A. SINTEZA**

- Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve:
- Partia “Aleanca Demokratike” ka deklaruar të ardhura nga fondet publike me vlerë neto për 588,875 lekë edhe pse të arkëtuara me dt. 09.09.2019, shtatëdhjetë (70) ditë pas përfundimit të fushatës zgjedhore në raportin e saj financiar për fushatën zgjedhore, dorëzuar në KQZ me nr.prot. të saj 14543, datë 10.10.2019 <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/10/Partia-Aleanca-Demokratike-e-Shqiperise-14102019155721.pdf>.
- Nuk ka paraqitur saktë vlerën e shpenzimeve në shumën 447,410 lekë në raportin e saj financiar për fushatën zgjedhore, dorëzuar në KQZ me nr.prot. të saj 14543, datë 10.10.2019 <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/10/Partia-Aleanca-Demokratike-e-Shqiperise-14102019155721.pdf>

##### **Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit:**

- Partia “Aleanca Demokratike ” nuk ka hapur llogari bankare për fushatën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.
- Partia “Aleanca Demokratike ” nuk respekton kërkesat e ligjeve fiskale për raportim të shpenzimeve të saj të shoqëruara me faturat tatimore me emër dhe me NIPT të saj.
- Ajo raporton blerje vetëm me kuponë tatimorë të pa shoqëruar me faturat tatimore përkatëse.
- Raporti financiar i fushatës zgjedhore që ka deklaruar partia “Aleanca Demokratike”, ka mospërputhje me kërkesat e pikës 2, të nenit 24/3, të ligjit nr.8580 dt.17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar.

Si rrjedhojë e mosrespektimit të kërkesave ligjore sa më sipër cituar, janë paraqitur jo saktë si shpenzime të fushatës zgjedhore në raportin financiar të partisë “Aleanca Demokratike” për fushatën zgjedhore, dorëzuar në KQZ me nr.prot. të saj 14543, datë 10.10.2019 <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/10/Partia-Aleanca-Demokratike-e-Shqiperise-14102019155721.pdf> si më poshtë:

- a) Partia AD nuk paraqet të ardhura gjendjen që ka Partia politike, duke përfshirë burimin dhe datën e përfitimit, për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve gjendjen në llogarinë bankare të saj prej 3,750 lekësh, vlerë e mbartur që nga data 31 dhjetor 2017.

Rr. “Milto Tutulani”, ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

- b) AD paraqet si shpenzime zgjedhore shpenzimet e aktivitetit të zakonshëm të Partisë për energjinë elektrike sipas faturave të OSHE-së (në emrin e partisë "Aleanca Demokratike") në vlerën 7,808 lekë.
- c) AD paraqet si shpenzime telefonie dhe interneti, vetëm sipas kuponëve tatimorë të Albtelekom-it vlerën 15,000 lekë për periudhën 01.01.2019-26.09.2019.  
Kuponët tatimorë nuk janë në emrin e partisë "Aleanca Demokratike" (sqaruar dhe me nr. 123 të kompanisë Albtelekom me datë 18.12.2019, ora 20,01-20,03).
- d) Shpenzimet e paraqitura si shpenzime kancelarie në vlerën totale 600 lekë (për muajin maj 2019-600 lekë) janë pa faturë tatimore.
- e) Raporton si shpenzime të fushatës zgjedhore vlerën prej 11,000 lekësh, të paspecifikuar, që justifikohen vetëm me kuponë tatimorë (23.05.2019 vlerën 1,000 lekë: nuk rakordon me datën e paraqitur në raportin financiar dhe me 03.07.2019-11,000 lekë).
- f) Raporton si shpenzime të fushatës shpenzime karburanti vlerën 12,785 lekë, justifikuar vetëm me kuponë tatimorë, pa fatura tatimore.  
Këtu duhet theksuar që nga Partia nuk raportohen si aset në pronësi të saj autovetura. Ajo nuk ka as kontrata për marrjen me qira të autoveturave për llogari të saj apo raportim të lëvizjeve gjatë muajit qershor 2019 me autovetura të shërbimit taksi.  
Vlera e karburanteve të paraqitura të blera vetëm me kuponë tatimorë në muajin qershor 2019 është 8,938 lekë, ndërsa vlera prej 3,847 lekësh i takon datës 03.07.2019.
- g) Partia "Aleanca Demokratike" raporton si shpenzim të fushatës zgjedhore vlerën prej 325,275 lekësh që përfaqëson derdhjen me datë 23.04.2019 për llogari të KQZ-së, në degën e thesarit, Tiranë, me nr. 3296, me nr. llogarie 0104030780, të detyrimeve që kishte ndaj saj nga viti 2017 për 325,000 lekë dhe komisionin bankar për 275 lekë.
- h) Nuk kanë as kuponë tatimorë e as fatura tatimore vlerat:
- 1,000 lekë e datës 15.05.2019-Endri Dizdari,
  - 2,200 lekë e datës 27/06/2019-Kastrati Sh.P.K.
  - 3,544 lekë e datës 30.06.2019 -OSHE.

Ka diferenca në raportim prej vlerave të kuponëve tatimorë:

- 900 lekë raportuar më tepër se kuponi tatimor i datës 24.06.2019 nga Ervis Meta
- 98 lekë janë të parakorduar me vlerat e kuponëve tatimorë të paraqitur në blerjet e raportuara.

Fondi zgjedhor nuk është përdorur nga partia "Aleanca Demokratike" sepse:

- Partia nuk ka paguar shpenzime për fushatën zgjedhore të qershorit 2019 sepse nuk ka paguar as nga fondet që ka patur gjendje (paraqitet vetëm një vlerë prej 3,750 lekësh gjendje në çelje në llogarinë bankare të saj pranë UB, dega Tiranë, tek Blloku me IBAN: AL 43214111680196449985020118-lekë) dhe as nga fondet e xhiruara nga buxheti i shtetit sepse vlera prej 588,875 lekësh është tërhequr me datë 09.09.2019.
- Fatura e blerjes për llogari të fushatës zgjedhore të datës 30.06.2019 me vlerë totale prej 67,200 lekësh (fiojora 18,000 copë me çmim me tvsh 3.7333/copë), me numër serial 54398554, nr. rendor 14, datë 03.07.2019 nga SHPK "Grafon", me NIPT K31520053F e cila nuk është paraqitur gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore rezulton e palikuiduar si nga arka (s'ka kupon tatimor) ashtu edhe nga banka llogari likuiduese e PAD.

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail: [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





**Krahasimi me raportin e monitorimit të ekspertit financiar:**

- Në raportin e monitorimit të ekspertit financiar është theksuar që nga partia politike "Aleanca Demokratike" në lidhje me kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruara nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit, nga partia "Aleanca Demokratike" nuk na u paraqit asnjë lloj dokumenti financiar me shpjegimin që Partia nuk ka pasur dhe nuk ka synim të zhvillojë fushatë elektorale.<sup>4</sup>
  - Edhe aty është vërejtur se nuk ka llogari bankare të hapur posaçërisht për fushatën zgjedhore të datës 30 qershor 2019 si dhe nuk është arritur të gjenden fakte për shpenzime të kryera gjatë fushatës zgjedhore qershor 2019 si nga zyra qendrore e partisë ashtu edhe nga kandidatët e saj<sup>5</sup>.
  - Në raportimin e monitorimit nuk është raportuar si shpenzim meqë nuk është paraqitur as si faturë fizike për llogari të fushatës zgjedhore të datës 30.06.2019 fatura e blerjes me vlerë totale prej 67,200 lekësh (fajora 18,000 copë me çmim me tvsh 3.7333/copë), me numër serial 54398554, nr. rendor 14, datë 03.07.2019 nga SHPK "Grafon", me NIPT K31520053F dhe nuk janë ekspozuar as edhe fizikisht këto fletëpalosje në procesin e monitorimit.

**B. PËRFUNDIMI**

**Opinionit me rezervë**

Ne kemi audituar raportin financiar të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, të cilat përfshijnë të ardhurat e përfituara dhe të gjitha shpenzimet e kryera nga partia politike "Aleanca Demokratike", për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve me 05.12.2018 deri në ditën e zgjedhjeve 30.06.2019, si dhe bilancin e pasurive dhe detyrimeve që mbyllen deri me 30.06.2019.

Sipas opinionit tonë, raporti financiar bashkëlidhur nuk paraqet drejt në të gjitha aspektet materiale shpenzimet e kryera për fushatën zgjedhore nga partia politike "Aleanca Demokratike", për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve 05.12.2018 deri në ditën e zgjedhjeve me datë 30.06.2019 dhe bilancin e pasurive dhe detyrimeve që mbyllen deri me 30.06.2019, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

**Theksim i çështjes:**

Ne tërheqim vëmendjen, për shënimin e datës së arkëtimit të të ardhurave nga fondet publike pas datës së mbarimit të fushatës zgjedhore. Opinioni ynë nuk është modifikuar për këtë çështje.

**Baza për opinionin**

Ne kryem procedurat për auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit. Ne jemi të pavarur nga subjekti zgjedhor në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave, raporteve financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme për të dhënë një bazë për dhënie të opinionit tonë dhe theksimit të çështjeve në dhënie të opinionit.

<sup>4</sup> RAPORTI I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA "ALEANCA DEMOKRATIKE", fq 9

<sup>5</sup> RAPORTI I MONITORIMIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019 PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR PARTIA "ALEANCA DEMOKRATIKE", fq 12

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,

Njësia administrative 5 - Tiranë

Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;

e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail : [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)





## AUDITUESE LIGJORE

FATMIRA SYKJA - KASTRATI

NIPT K46523036S NR LICE NCE 14, datë 11/01/2000

Për sa parashtruar më sipër, rezulton që vlera e shpenzimeve e paraqitur në raportin financiar të saj për fushatën zgjedhore, dorëzuar në KQZ me nr.prot. të saj 14543, datë 10.10.2019 <http://cec.org.al/ep-content/uploads/2019/10/Partia-Aleanca-Demokratike-e-Shqiperise-14102019155721.pdf> është e pasaktë për shumën prej 380,210 lekësh nga vlera totale e shpenzimeve të raportuara prej 447,410 lekësh.

15

### AUDITUESE LIGJORE

Fatmira KASTRATI (SYKJA)

Tiranë, më 19 dhjetor 2019



---

Rr. "Milto Tutulani", ndërtesa 6, hyrja 9, kodi postar 1019,  
Njësia administrative 5 - Tiranë  
Mobile: +355 (0) 692086610; Office: +355 (0) 42202051;  
e-mail: [mira\\_kastrati@yahoo.it](mailto:mira_kastrati@yahoo.it); e-mail: [mira\\_kastrati@hotmail.it](mailto:mira_kastrati@hotmail.it)

